



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës
Opstina Dakovica-Municipality of Gjakova



Në bazë të nenit 89.2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149, nenit 10.3 të Rregullorës për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nr. 01/2011 dhe pikës IV të Vendimit nr. 112-789/2014 të datës 22.01.2014, Kryetarja e Komunës së Gjakovës me datën 24/03/2016 merr këtë

V E N D I M

1. Anëtari i deritanishëm i Kuvendit të Komunës së Gjakovës z. Hamëz Cena, pas mbarimit të pezullimit të dakorduar, emërohet në pozitën Drejtor i SHFMU "7 Shtatori" në fshatin Gërqinë, Komuna e Gjakovës me koeficientin 7.2.
2. Nënpunësi civil Hamëz Cena emërohet në vendin e punës nga pika 1 e këtij Vendimi për mandatin prej 4 viteve duke filluar nga data 01.04.2016 kur edhe duhet të lajmërohet në vendin e ri të punës.

A R S Y E T I M I

Nënpunësi civil Hamëz Cena ishte zgjedhur si anëtar i Kuvendit Komunal të Gjakovës në zgjedhjet lokale të mbajtura me datën 03.11.2013. Në kohën e zgjedhjes, nënpunësi cilil ishte i caktuar në vendin e punës Udhëheqësi i sektorit për arsim.

Në momentin e zgjedhjes së tij si anëtar i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, atij iu janë pezulluar të drejtat nga marrëdhënia e punës, koform dispozitave ligjore.

Me datën 12.02.2016, nënpunësi Hamëz Cena me vetëdëshirë e ndërpreu mandatin e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, duke e përfunduar, në këtë mënyrë, pezullimin e dakorduar.

Në kuptim të zgjidhjes së statusit të tij pas përfundimit të pezullimit të dakorduar, Kryetarja e Komunës së Gjakovës morri këtë vendim për emërimin e tij në vendin e punës së cekur në pikën 1 të dispozitivit, konform zgjedhjeve të ofruara nga dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorës për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, shërbyesi civil ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

Kryetarja e Komunës së Gjakovës

znj. Mimoza Kusari - Lila

I dorëzohet:
Nënpunësit z. Hamëz Cena;
Drejtorisë për arsim;
Drejtorisë për buxhet dhe financa;
Udhëheqësit të personelit;
Arkivit